



RREGULLORE E PUNËS SË BORDIT DREJTUES TË KOLEGJIT RIINVEST

Prishtinë

23 Nëntor 2017

BPrAL Kolegji Riinvest sh.a.
BORDI DREJTUES

Në bazë të dispozitave të nenit 14 të Statutit të BPrAL Kolegji Riinvest (në tekstin e mëtejshëm Kolegji), Bordi Drejtues i Kolegjit, i grumbulluar në mbledhjen e mbajtur më 23 nëntor 2017 në selinë e Kolegjit në Prishtinë, ka miratuar këtë:

RREGULLORE TË PUNËS SË BORDIT DREJTUES TË BPrAL KOLEGJI RIINVEST

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Bordi Drejtues i Kolegjit është organi më i lartë drejtues i Kolegjit, i përbërë nga gjashtë anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Aksionarëve të Kolegjit, në pajtim me ligjet e zbatueshme, Statutin e Kolegjit dhe aktet tjera normative të tij. Për punën e vet, Bordi Drejtues i përgjigjet Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit.
2. Bordi Drejtues është përgjegjës për të menaxhuar me veprimtarinë e Kolegjit mes dy Kuvendeve të Aksionarëve dhe vepron në pajtim me Statutin dhe aktet normative të Kolegjit dhe me këtë Rregullore të Punës të punës së vet.
3. Bordi Drejtues i bartë të gjitha përgjegjësitë për menaxhimin e Kolegjit të cilat në mënyrë shprehimore me Statut nuk i jepen Kuvendit të Aksionarëve. Ngjashëm, Bordi Drejtues do të miratojë të gjitha aktet normative për të cilat bartë përgjegjësi statutoare dhe ligjore, si dhe të gjitha vendimet dhe rregulloret e nevojshme për të siguruar funksionim ligjor të Kolegjit.
4. Anëtarët e Bordit Drejtues kanë mandat trevjeçar, me mundësi rikandidimi dhe rizgjedhjeje, ndërsa mandati i tyre do të skadojë tek pas marrjes së detyrës nga Bordi i ri Drejtues, përveç në rastet kur mandati humbet si rrjedhojë e vdekjes, shkarkimit apo dorëheqjes, me ç'rast Bordi Drejtues me vota unanime mund të vendosë për zëvendësimin e anëtarit në fjalë me një anëtar tjetër i cili këtë mandat do ta mbajë deri në mbledhjen e parë të radhës të Kuvendit të Aksionarëve të Kolegjit.
5. Bordi Drejtues mund të krijojë trupa dhe komisione të veta për t'i ndihmuar në realizimin e detyrave dhe kompetencave që i ka. Në rast të krijimit të trupave dhe komisioneve të tilla, Bordi Drejtues do të përcaktojë edhe mandatin, kohëzgjatjen dhe detyrat e tyre. Trupat e tilla do të kenë karakter këshillëdhënës dhe/ose funksional, por nuk mund të ushtrjnë veprimtari normative.
6. Bordi Drejtues ka të drejtë që të ftojë për raportim të gjithë punonjësit e Kolegjit dhe/ose persona të tretë, nëse raportimin e tyre para Bordit Drejtues e konsideron si të dobishëm apo nevojshëm për veprimtarinë e vet.

Neni 2

Delegimi i kompetencave të Bordit Drejtues

1. Bordi Drejtues i Kolegjit mund të krijojë këshilla dhe komisione *ad hoc*, në rast se të njëjtat konsiderohen si të domosdoshme për funksionimin e tij. Në rast të tillë, Bordi Drejtues atyre do t'ua përcaktojë detyrat, kohëgjatësinë, kompetencat dhe fushëveprimtarinë funksionale. Puna në trupa të tilla punuese do të zhvillohet në analogji me procedurat e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Bordi Drejtues i Kolegjit mund t'ia delegojë kryerjen e një detyre të caktuar edhe një personi të vetëm.
3. Bordi Drejtues i Kolegjit mund ta autorizojë njërin nga punonjësit profesional të Kolegjit që të kryejë ndonjë punë që është nën kompetencën e Bordit Drejtues.

Neni 3

Kuorumi, mbledhjet dhe vendimmarrja në Bordin Drejtues

1. Mbledhjet e Bordit Drejtues i fton Sekretari i Kolegjit, me kërkesë të Kryetarit apo tre anëtarëve të Bordit Drejtues, të cilët kërkesën në fjalë e parashetrojnë në formë të shkruar para Kryetarit dhe Sekretarit të Kolegjit.
2. Punimet e Bordit Drejtues i udhëheq Kryetari i Kolegjit. Në mungesë të Kryetarit, punimet e Bordit Drejtues mund t'i udhëheqë një anëtar tjetër i autorizuar nga Kryetari me shkrim, apo anëtari më i vjetër i Bordit Drejtues i pranishëm në mbledhje. Mbledhjet e Bordit Drejtues konvokohen me dërgimin e ftesës tek të gjithë anëtarët, jo më vonë se dy ditë para mbajtjes së saj. Mbledhjet e rregullta të Bordit Drejtues do të mbahen jo më rrallë se një herë në çdo muaj kalendarik.
3. Bordi Drejtues vendimet e veta i merr me shumicë votash në të gjitha mbledhjet e Bordit Drejtues në të cilat të pranishëm janë së paku katër anëtarë, e të cilat janë konvokuar në mënyrë të rregullt dhe në pajtim me ligjet e zbatueshme, Statutin e Kolegjit dhe këtë Rregullore të Punës së Bordit Drejtues. Bordi Drejtues mund të merr vendime edhe në formë elektronike edhe në bazë të nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
4. Vendimet e Bordit Drejtues merren me shumicën e votave të hapura të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje në të cilat ka kuorum. Në rast se një propozim merr vota të barabarta për dhe kundër, vota e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve do të konsiderohet përcaktuese. Përrjashtimisht kësaj dispozite, ligjet e zbatueshme, Statuti i Kolegjit, apo Rregullorja e Punës së Bordit Drejtues mund të përcaktojnë që për disa çështje të caktuara të kërkohet shumica e votave të të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues ose ndonjë shumicë tjetër e kualifikuar e tyre.

Neni 4

Punimet e Bordit Drejtues

1. Anëtarët e Bordit Drejtues të Kolegjit për mbledhjet e Bordit njoftohen përmes ftesave elektronike, të cilat dërgohen së paku dy ditë para mbajtjes së mbledhjes. Anëtarët e Bordit Drejtues duhet ta konfirmojnë pranimin e ftesës dhe pjesëmarrjen në mbledhje gojarisht apo me shkrim.
2. Rendi i ditës për mbledhjet e Bordit Drejtues dhe ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit Drejtues, krahas të gjitha dokumenteve të cilat do të shqyrtohen në mbledhjen e konvokuar, duhet t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues së paku një ditë para mbledhjes së Bordit.
3. Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues kanë të drejtë të kërkojnë përfshirjen e ndonjë pike relevante në rendin e ditës për mbledhjen vijuese, deri në gjashtë orë para kohës së paraparë për mbajtjen e mbledhjes së Bordit. Kjo kërkesë duhet t'i parashtrohet me shkrim Kryetarit apo Sekretarit të Kolegjit, në formë fizike apo elektronike.
4. Mbledhjet e Bordit Drejtues i kryeson Kryetari i tij. Në mungesë të tij, me autorizim paraprak me shkrim, mbledhjet e Bordit mund t'i kryesojë një nga anëtarët e Bordit Drejtues. Në mungesë të Kryetarit apo një autorizimi të tillë, mbledhjet e Bordit Drejtues i kryeson anëtari më i vjetër i tij.
5. Në mbledhjet e Bordit Drejtues, për secilën pikë të rendit të ditës çdo anëtar ka të drejtë të diskutojë vetëm njëherë dhe atë jo më gjatë se 5 (pesë) minuta. Replika lejohet vetëm nëse emri i anëtarit është apostrofuar dhe mund të zgjatë jo më shumë se 2 (dy) minuta. Kryesuesi i mbledhjes mund të lejojë përjashtim nga kjo dispozitë, në rast se atë e konsideron të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Bordit Drejtues.
6. Anëtarët e Bordit Drejtues duhet t'i përmbahen kodit të etikës dhe sjelljes profesionale përgjatë tërë veprimtarisë së tyre, në pajtim me dispozitat e ligjeve të zbatueshme dhe Statutit të Kolegjit.
7. Në rast të mosrespektimit dhe mospërfilljes së paragrafëve 5 dhe 6 të këtij neni, Kryetari i Kolegjit, ose Kryesuesi i mbledhjes ka të drejtë që anëtarit t'ia marrë fjalën dhe/ose kërkojë largimin e tij të përkohshëm nga punimet e Bordit.
8. Për të gjitha mbledhjet e Bordit Drejtues mbahet procesverbali nga Sekretari i Kolegjit, apo në mungesë të tij nga ndonjë i punësuar apo ndonjëri prej anëtarëve të Bordit Drejtues, në bazë të autorizimit nga Kryetari i Kolegjit. Procesverbali duhet t'i përmbajë të gjitha vendimet e nxjerra nga Bordi Drejtues si dhe të gjitha diskutimet substanciale në favor apo kundër vendimeve përkatëse.
9. Procesverbali i mbledhjeve të Bordit Drejtues mbahet në formë të plotë arkivat e Kolegjit, ndërsa ekstrakti i të njëjtit u dërgohet të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja paraprake e Bordit bëhet në mbledhjen e parë vijuese të tij, si pikë e parë e rendit të ditës.

10. Në rendin e ditës për mbledhjet e Bordit Drejtues, raportimi para Bordit Drejtues i Rektorit të Kolegjit, si dhe i udhëheqësve të njësive tjera funksionale të Kolegjit, do t'u paraprijë vendimeve të cilat i merr Bordi Drejtues dhe miratimit të akteve normative të cilat i nxjerr Bordin Drejtues.

Neni 6

Vendimet e Bordit Drejtues të Kolegjit

1. Vendimet e Bordit Drejtues të Kolegjit mund të merren me shumicë votash në njëren nga dy mënyrat në vijim:

a) Në mbledhje të Bordit të Kolegjit, në të cilën të pranishëm janë së paku shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues. Vendimet e Bordit Drejtues të Kolegjit do të jenë të vlefshme në rast se për to votojnë shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues të pranishëm në mbledhjen në fjalë.

b) Përmes deklaramentit elektronik të anëtarëve të Bordit Drejtues, me ç'rast vendimet janë të vlefshme vetëm në rast se për miratimin e tyre deklarohen shumica e të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues të Kolegjit. Materialet përcjellëse dhe forma e projektvendimit që mëtohet të nxirret përmes formës së përcaktuar në këtë nënparagraf duhet të dërgohen së paku një ditë para afatit të përcaktuar për deklarament elektronik.

2. Propozimet për nxjerrjen e vendimeve sipas formës së përcaktuar në nënparagrafin b) të paragrafit 1 të këtij neni i përgatitë Kryetari i Kolegjit, ndërsa i administron Sekretari i Kolegjit. Propozimet e miratuara në formë elektronike u dërgohen të gjithë anëtarëve të Bordit Drejtues, përkrah njoftimit mbi votimin për to nga secili anëtar i tij.

3. Të gjitha vendimet e nxjerra në pajtim me këtë Rregullore të Punës nga Bordin Drejtues i Kolegjit kanë karakter detyrues për të gjithë punonjësit e Kolegjit.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore e Punës së Bordit Drejtues të Kolegjit hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Bordin Drejtues dhe nënshkrimit nga Kryetari i Bordit Drejtues të Kolegjit.

Rasim Mrlaku
Kryetar i Kolegjit Riinvest